

PERMBAJTJA

1. Decentralizimi politik, nëpërmjet sistemit “një anëtar një votë”
Nga Reis MULITA, PSDf. 3
2. Etika e munguar në qeverisje ose rasti “Shqipëria”
Nga Arta SAKJA, PDf. 4
3. Proçesi i përzgjedhjes së lidershit politik
Nga Taulant BALLA, PSf. 5
4. Shqipëria – vendi me kryetarë, por pa parti
Nga Alma LAHE, PBDNJf. 6
6. Qeverisje me pjesëmarrjen e publikut
Nga Artan ÇELA, PSf. 6
5. Sistemi zgjedhor në Shqipëri, ç’është dhe ç’duhet të jetë
Nga Arben QIRJAKO, PD.....f. 7
7. Është koha për të dëgjuar
Nga Antoneta MALJA, PD.....f. 8
8. Bashkimi i opozitës - nevojë dhe domosdoshmëri
Nga Desdemona GABA, PBK..... f. 8
9. Në vorbullën e realitetit të politikës shqiptare
Nga Anuela KONDI, PSf. 9
11. Prona private “element sigurie” për Passaportën Europiane të Shqipërisë.
Nga Edvin ZOTO, PR f. 10
11. Shqiptarët dhe Fqinjët
Nga Florian XHUTI, PBK..... f. 11

Disa nga fotot e publikuara ne kete Reviste jane marre nga LSA

EDITORIAL

MIRSEARDHJE

Mirëseerdhët në numrin e tretë të revistës Politikani i Ri!



Nga Guri DACO

Në ndryshim nga numrat e kaluar ku ne i dhamë më tepër rëndësi pasqyrimin të aktiviteteve dhe demonstrimit të arritjeve të pjesmarrësve të programit të NDI mbi Menaxhimin Politik, në faqet e brendshme të këtij numri ne jemi munduar të bëjmë një ndryshim i cili shpresojmë të mirëpritet prej jush.

Gjithçka në këtë numër do t’i kushtohet zërit dhe mendimit të politikanëve të rinj pjesmarrës të këtij programi. Ata i përkasin partive kryesore të spektrit politik shqiptar dhe vijjnë me mendimet e tyre për atë se çka ata mendojnë se duhet të dëgjohej prej audiencës së këtij botimi. Përzgjedhja e temave që trajtohet në këtë botim është natyrale dhe e vendosur nga vetë kontribuesit. Gjithashtu ky numër do të sjellë mendimet e disa prej drejtuesve të lartë të partive politike shqiptare të cilat janë të përfaqësuar në programin e NDI mbi menaxhimin politik.

Ideja për këtë ndryshim në përmbajtjen e revistës ka lindur nga nevoja që ne mendojmë se egziston në shtypin shqiptar për një revistë politike e cila do të ishte një forum i hapur për të gjithë zërat e politikës shqiptare, por sidomos për zërat e një klase të re politike që po zhvillohet në Shqipëri. Kjo është një tentativë e parë që stafi i botimit të kësaj reviste ka ndërmarë për t’iu dhënë mundësinë së pari anëtarëve të programit tonë të shprehin mendimet e tyre të pavarura. Në çdo rast mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë botim janë ato të autorëve dhe si të tilla nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e NDI. Natyrisht ne do të mirëprisim vërejtjet dhe komentet tuaja për të bërë përmirësime në numrat e ardhshëm.

Guri Daco

KUSH JANË NJERËZIT E NDI

BORDI I DREJTORËVE TË INSTITUTIT KOMBËTAR DEMOKRATIK

Madeleine K. Albright	<i>Kryetare</i>
Kenneth D. Wollack	<i>President</i>
Robert Benjamin	<i>Drejtor Rajonal</i>
Catherine Messina Pajic	<i>Zëvendës Drejtoreshë Rajonale</i>
William Hayden	<i>Përgjegjës i Lartë i Programit</i>
Megan Unangst	<i>Asistente e Programit</i>

STAFI I PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT TË PARTIVE POLITIKE, NDI – SHQIPËRI

Jennifer L. Butz	<i>Drejtoreshë e Zyrës Vendore dhe e Programit Forumi Civil</i>
Dan Redford	<i>Drejtor i Programit për Partitë Politike</i>
Guri Daco	<i>Asistent i Programit për Partitë Politike</i>
Enri Prodani	<i>Konsulent i Programit për Partitë Politike</i>



Decentralizimi politik, nëpërmjet sistemit “një anëtar një votë”

nga Reis MULITA,
Përgjegjës për Mardbëniët me Median pranë PSD-së

NË SHQIPËRI MËSON SE demokracia në partitë politike dhe jetën e vendit u ndërta në një dekadë, teksa dëgjon udhëheqësit e partive politike të spektrit

politik të majtë e të djathtë, të mëdha e të vogla, të shprehen se partitë që ata drejtojnë bëjnë jetë demokratike, kanë vendimmarrje demokratike e se do të ndërtojnë shoqërinë demokratike. Ndërtimi i shoqërisë me demokraci politike e qeverisëse, është një nga arritjet më të mëdha dhe më të përparuara në mekanizmin e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë njerëzore dhe kjo është arritur në shekuj përjekjesh eksperiencash pozitive e negative.

Mënyra se si janë zhvilluar zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe vendore, mënyra se si zhvillohen zgjedhjet në vetë partitë politike, shkalla e lartë e përqendrimit të pushtetit politik dhe administrativ nga shumicat partiake, mënyra se si operohet me administratën publike dhe civile, transparenca në vendimmarrje, tregon se vendi është ende në fazën përgatitore të ndërtimit të demokracisë, madje në shumë tregues po aplikohet në mënyrë jo zhvilluese.

Decentralizimi i pushtetit politik dhe pavarësia e pushteteve qeverisëse, në praktikën e vendeve me demokraci liberale të përparuar, është përcaktuar si mekanizmi më efikas, si edhe është cilësuar si matës i shkallës së demokracisë në një etapë të caktuar të zhvillimit të shoqërisë me sistem politik pluripartiak. Ndërsa shkalla e demokracisë në jetën e brendshme të vetë partive politike është reflektim i drejtpërdrejtë i shkallës së demokracisë në jetën e një vendi

E thënë publikisht apo në heshtje, në Shqipëri është fakt i padiskutueshëm që partitë politike drejtojnë jetën shoqërore e politike në nivel qendror dhe vendor, në qeverisjen qendrore, deri në njësitë më të vogla vendore. Kështu, partitë politike zgjedhin deputetët, qeveritarët, kryetarët e bashkive, minibashkive, komunave, kryepletqë, administratën publike dhe civile, përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Kolegjin Zgjedhor, entet rregullatore, Këshillin Rregullator të RTV... pra gjithshka, ashtu sikundër edhe në sistemin politik uniparti, vetëm se në rastin konkret seleksionimi nuk bëhet nga një, por nga “disa” parti.

Përderisa partitë politike ndikojnë drejtpërdrejt në shkallën e demokracisë në vend, decentralizimi duhet së pari të fillojë nga jeta e brendshme e partive politike. Problemi që shtrohet lidhur me çështjen në fjalë është ai i mekanizmit dhe matshmërisë së demokracisë së brendshme të partive politike. Të gjithë liderët aktualë dhe partitë politike sot shprehen se funksionojnë mbi bazën e demokracisë së brëndshme, e ndërsa nuk është e lehtë të kuptosh se, edhe sikur të duash, nuk mund të ndërtohet demokraci në jetën e një partie në një kohë relativisht të shkurtër. Për shkak të së kaluarës dhe të tashmes të historisë së pluralizmit në vend,

sistemi një anëtar një votë mund të jetë ilaçi më i mirë për trajtimin e manisë dhe prirjes së lidhshpimit për përqendrim të pushtetit dhe praktikimin e decentralizimit ose demokracisë politike në jetën e vetë partive politike, në vend të përqendrimit të pushtetit politik e atij administrativ nga Ai.

Është e tepërt të flasësh për emra apo moshë të lidhshpimit, pasi ata i sjell në skenë mënyra se si funksionojnë institucionet partiake.

Një anëtar një votë do të thotë që Kryetarin e Partisë ta votojnë të gjithë anëtarët e partisë.

...vijon në f. 4



Jozefina TOPALLI,
NËNKRYETARE E PD

**NDI ka prezantuar në Shqipëri një
frymë të re të sjelljes politike.**



Arben MALAJ,
MINISTËR I FINANCAVE

**NDI nëpërmjet programeve për grupet
parlamentare, për trainimin e
politikanëve të rinj, për barazinë në
përfaqësimin gjinor i ka shërbyer më
së miri krijimit të një profili modern
të klasës politike shqiptare.**



Neritan ALIBALI,
NËNKRYETAR I PR

**Programi i Menaxhimit Politik për
politikanët e rinj është një eksperiencë e
madhe që do t'i shërbejë
demokratizimit të partive politike dhe
politikës shqiptare në tërësi.**

...vijon nga f. 3 Në Shqipëri kryetari i partisë në nivel kombëtar apo vendor nuk zgjidhet nga anëtarësia, atë e zgjedhin delegatët. Të gjithë e dimë se si zgjidhen delegatët. Kryetari i partisë në nivel vendor përzgjedh delegatët që e zgjedhin atë kryetar, ai zonal zgjedh delegatët që e zgjedhin atë kryetar, e kështu procesi zinxhir i kontrollit të situatës në funksion të zgjedhjes së kryetarit të dëshiruar, me apo pa dije nga delegatët e çon ujin në mullirin e duhur deri tek "Ai".

Një anëtar një votë kërkon që vendimmarrjet e partive politike për politikën kryesore të kenë miratimin e anëtarësisë së partisë me votë të drejtëpërdrejtë. Asnjë nga partitë politike nuk e miraton në anëtarësi programin qeverisës apo të kundërshtisë opozitare. Anëtarëve të partisë i kërkohet vota për deputetët, kryetarët e bashkive dhe komunave, këshilltarët e tyre, por jo për programin dhe politikën, përzgjedhjen e emrave e kështu me radhë. Pra, demokracia është e mangët, e njëanëshme, vetëm detyrim, jo e drejtë për të përzgjedhur programe dhe emra, në rastin më të mirë është formale.

Një anëtar një votë, midis të tjerash, do të thotë efektivitet dhe legjitimitet. Sistemi në fjalë realizon përzgjedhjet më të mira për fitore. Votimi dhe pranimi nga anëtarësia i vendimmarrjeve, automatikisht sjell mobilizimin e anëtarësisë për fitore, *përndryshe fenomeni i çarjes në parti është i pashmangshëm*, çka ndikon drejtpërdrejt në rezultatet elektorale. Shkalla e përsosjes së demokracisë në sistemin "një anëtar një votë" kërkon edhe sensibilizim paraprak për vendimmarrjet nëpërmjet votimit, me qëllim eliminimin e manipulimit masiv të anëtarësisë.

Një anëtar një votë midis të tjerash parakupton disiplinë partiake, të lindur mbi legjitimitetin dhe pranueshmërinë e shumicës. Është kjo arsyeja që parti të tilla si ajo Laburiste angleze, të cilës shpesh na pëlqen t'i referohemi si shembull i përparuar, praktikojnë disiplinën partiake e parlamentare. Disiplina është pjesë e demokracisë reale.



ETIKA E MUNGUAR NE QEVERISJE OSE RASTI "SHQIPERIA"

Nga Arta SAKJA,

Anëtare e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike

RASTET SPORADIKE të "news-ve" mbi sjelljen e zyrtarëve më të lartë publikë, e më gjerë, sjelljen e politikanëve, kryesisht atyre të përfshirë në vendim-marrje, duket të jenë konsi-deruar të mjaftueshme për ta mbyllur një debat që nuk u hap kurrë mbi etikën e qeverisjes në Shqipëri, ndërkohë që diskutimet mbi këtë temë në demokracitë e zhvilluara, edhe në ato liberale, zgjerohen edhe mbi perspektivën.

Është e vërtetë se debati i fokusuar në standartet morale të figurës dhe sjelljes së zyrtarit të lartë publik dhe në detyrimet e imponuara nga mjedisi politik, pritshmëritë e publikut dhe normat e perfeksionit në Shqipëri ka trajtën e një diskutimi momental dhe përqëndrohet në nivelin e sjelljes personale ose individuale të zyrtarit publik, sepse *debati hapet vetëm me shtytë dhe për qëllime të caktuara politike, në funksion të kokëkrisjes së politikanëve që përdorin median, sa herë duhet të sulmohet politikisht kundërshtari jo vetëm i kabut tjetër ideologjik*, sulme që nuk njohin rrugëtimin drejt organeve të gjyqësorit apo krijimin e agjensive që do të zbutnin këtë fenomen.

Teoritë mbi etikën në qeverisje janë të lidhura me veprimtarinë vendimmarrëse dhe mund të përkthehen ndryshe si përgjegjësi publike, e cila në vetvete nënkupton: profesionalizëm, pjesëmarrje dhe transparencë.

Zbatimi i tyre në *rastin Shqipëria*, për fat të keq gjen vetëm antitezën. Numërimi i tyre do të ishte një revistë e shëmtuar që do të dëshmonte etikën e munguar në qeverisje. Profesionalizmi teorikisht shpesh kushtëzohet nga përmbajtja në disa standarte të caktuara e zakonisht në nënshkruarjen e një kodi etik që udhëheq praktikën profesionale të zyrtarit publik.

Mbi profesionalizmin, vlerësimin e tij, kërkimet në rastin *Shqipëria* janë xeherorë të rrallë pasi, pavarësisht nga fjalët e bukura

që mund të kemi dëgjuar mbi të, kriteri bazë mbi të cilin Shqipëria vazhdon të cilësojë profesional dikë mbetet "partishmëria e lartë politike" e së fundmi dhe "besnikëria e lartë ndaj liderit".

Pjesëmarrja ndërkohë nënkupton që administratorët duhet të konsultojnë më shumë interesa dhe të dëgjojnë më shumë këndvështrime, duke lejuar partitë e ndryshme të marrin pjesë në vendimmarrje në mënyrë që procesi të bëhet më pak arbitrar dhe më pak subjektiv, si dhe të veprohet me më shumë përgjegjshmëri dhe më shumë përgjegjësi.

Transparenca, e cila mund të konsiderohet si një devizë e tretë mbrojtëse, duke drejtuar qendrën e vëmendjes së publikut në vendimarrjen administrative, vazhdon të mungojë. Media vazhdon të pengohet me urdhëra administrativë që të marrë informacion mbi vendimmarrjen, vazhdon të rrihet e të ndalohej për orë të tëra në polici.

Ndoshta është ende herët të nxisësh debate teorike në Shqipëri mbi kodin etik të shërbimit publik, ndërsa je aktor ose spektator i shfaqjeve korruptive, kur mjekun e paguan nën dorë, kur policin e paguan nën dorë, kur di që gjykatësi paguhet nën dorë, kur sheh deputetin të shkelë kurore, kur politikanin paguan nën dorë për votën, kur gjithkush njih pronë e kryepolicit, kryeprokurorit, kryegjykatësit të qytetit të vet dhe askush nuk denoncon, por mbetet personazh i thjeshtë, bashkëfajtor në krijimin e këtij realiteti korruptiv.

Por, ndoshta nëse ky debat do të zhvillohej me kohë, realiteti ynë 13 vjeçar nuk do të rezultonte i tillë siç po e dëshmojmë: nuk do të kishim këtë standart jetese, nuk do të kishim këtë minimum jetik, nuk do të kishim këtë nivel pagash, nuk do të kishim këtë mungesë të lodhshme energjie e uji, këto tarifa absurde telefonie, këtë gjyqësor që lë shumë për të dëshiruar, e ndoshta nuk do të kishim as këtë klasë politike.

PROCESI I PËRZGJEDHJES SË LIDERSHIPIT POLITIK



Nga Taulant BALLA, *Kësbilltar pranë Kryeministrit.*

PROÇESI I përzgjedhjes së lidershipit politik përbën një ndër parametrat kryesorë të performancës së demokracisë së brendshme për çdo formacion politik. Në vendet me sisteme politike pluripartiake një interes i veçantë fokusohet në mënyrën e adoptuar nga partitë politike për përzgjedhjen e liderit të partisë. Në historinë e partive politike mund të identifikohen pesë mënyra të përzgjedhjes së lidershipit:

(1) Nga një individ i veçantë. Kjo ndodh në ato raste kur individë të veçantë krijojnë parti politike si vegla të qëllimeve të tyre politike, për shëmbull Reverendi Ian Paisley dhe Partia Unioniste Demokratike në Irlandën e Veriut, ose në rastet kur lideri në largim paracakton pasardhësin, siç ka ndodhur në Partinë Liberal Demokratike japoneze.

(2) Nga një grup i vogël elitar, nëpërmjet votimit formal ose konsensusit aqarent. Kjo procedurë është e shpeshtë në ato parti politike që veprojnë në një sistem politik relativisht të centralizuar dhe mbështesin vlera elitare. Kjo formë është praktikuar nga Partia Konservatore Britanike deri në vitin 1965.

(3) Nga anëtarët e partisë të zgjedhur në parlament. Kjo metodë përdoret në partitë që veprojnë në sisteme politike parlamentare, e mbështetur në parimin që lideri i partisë është, në radhë të parë, lideri i grupit të deputetëve të partisë. Në Britani kjo metodë është përdorur nga Partia Laburiste deri në vitin 1981, Partia Liberale deri në vitin 1976 dhe Partia Konservatore ndërmjet 1965 dhe 1997.

(4) Nga kongresi i partisë ose kolegji elektoral. Kjo formë mbart karakteristika relativisht të njëjta si procesi i përfaqësimit në republikat parlamentare. Përfaqësues të zgjedhur të strukturave lokale të partive mblidhen në kongresin e partisë ose në kolegjin elektoral dhe votojnë lidershipin e tyre.

(5) Nga votimi i gjithë anëtarëve të partisë – “një anëtar, një votë”. Kjo konsiderohet të jetë specifike në ato vende ku partitë bazohen totalisht në anëtarësinë individuale. Në Britani, në vitin 1994 Partia Laburiste bëri një lëvizje drejt këtij sistemi, duke ia nënshtuar përzgjedhjen e liderit të partisë votës së anëtarësisë së plotë: të anëtarëve të grupit parlamentar, të anëtarëve të sindikatave dhe të anëtarëve të thjeshtë të partisë.

Procesi i zgjedhjes së kandidatëve për presidentë në Shtetet e Bashkuara, që nga viti 1970, ofron shembullin më të mirë për një metodë të gjashtë në përzgjedhjen e kandidatëve për presidentë, të cilët për sistemin partiak në këtë vend përbëjnë liderin kombëtar të partisë. E veçanta e këtij sistemi konsiston në faktin se gjatë procesit të zgjedhjes së kandidatëve për presidentë në “state primaries” ka të drejtë të marrë pjesë çdokush, pavarësisht përkatësisë partiake.

Në Shqipëri, me një sistem partiak *in nascita* mund të dallosh qartë ekzistencën reale apo formalitetin e disa prej metodave të parashtruara më sipër. Mund të identifikosh parti “personale”, parti të një grupi të caktuar individësh (pa vlera elitare) dhe parti që përzgjedhin lidershipin e tyre nëpërmjet metodave përfaqësuese.

Burimet njerëzore, kultura politike dhe mënyrat e organizimit janë të ndryshme për secilën nga partitë politike shqiptare, por mendoj se ekziston një horizont i përbashkët refleksioni dhe kërkimi se si t'i përgjigjemi krizës së politikës së vjetër, të formës së vjetër të partisë dhe për të reformuar pjesëmarrjen në politikë dhe demokraci. *Procesi i reformimit fillon nga mënyra e përzgjedhjes së lidershipit dhe menaxhimi i strukturave organizative.* Diskutimi dhe debati mbi çështje të tilla vitale për partitë politike nuk duhet të heshtë. Ato janë shfaqës të demokracisë së brendshme të partisë. Kur partitë “heshtin” dhe pranojnë “pa fjalë” sisteme të caktuara organizimi, ato humbin identitetin dhe besueshmërinë.

Në Shqipëri, Partia Socialiste mban të hapur debatin, pjesë konstruktive e së cilit është edhe përcaktimi i formës më efektive të përzgjedhjes së lidershipit, ku krahas formës aktuale me sistem përfaqësimi diskutohet edhe për sfidën “një anëtar – një votë”. Kjo çështje e rëndësishme vazhdon të jetë pjesë e diskutimit dhe e reflektimit të të gjithë anëtarëve të saj. Anëtarët janë ata që zgjedhin.



Sokol OLLASHI,
KRYETAR I FR PD

Programi i NDI ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në formatimin e politikanëve të rinj në Shqipëri.



Maqo LAKRORI,
SEKRETAR I MN NË PS

NDI është një mik i hershëm për demokracinë e re shqiptare. Kemi filluar kontraktet që në fillim të viteve '90 duke zgjeruar në mënyrë progresive hapësirat e bashkëpunimit.



Vangjel DULE,
KRYETAR I PBDNJ

Politika e trazuar shqiptare nuk ka nevojë vetëm për emra të rinj, por më tepër për një mentalitet përëndimor, që vendi të tejkalojë sa më parë dhe pa shumë kosto tranzicionin e tejzgjatur. Një ndihmesë të madhe në këtë drejtim po jep edhe NDI.

SHQIPERIA

VENDI ME KRYETARË, POR PA PARTI

Nga Alma LAHE,

Ko-ordinatore pranë PBDNj

ÇDO FUNDVITI të gjithë bëjnë bilancet e vitit që ikën dhe hartojnë programet dhe strategjitë për motmotin e ri. Këtë e bëjnë individët, institucionet, ndërmarrjet, qeveritë, shtetet, etj. Po partitë a bëjnë bilanc vjetor të arritjeve dhe mosarritjeve të tyre?

Gjatë vitit 2003, politika shqiptare dhe, kuptohet edhe promotorët e saj, partitë politike, për fat të keq jo vetëm të tyre por edhe të vendit, nuk kanë shënuar asnjë progres, megjithatë të gjitha trumbetojnë me të madhe se ky ka qenë "vit i sukseseve të mëdha".

Për të parë se sa të suksesshme kanë qenë gjatë 2003 partitë politike, le të marrim vetëm një element, atë të zgjedhjeve vendore, të cilat startuan më 12 Tetor dhe ende nuk dihet se kur do të përfundojnë(!?).

Pas shpalljes së rezultateve paraprake nga KQZ-ja, dy partitë e "mëdha", PS dhe PD, deklaruan (u vetshpallën) pa ngurrim se ato (secila prej tyre) ishin fitueset e zgjedhjeve(!?). Pra, nga gara dolën dy fitues të vendit të parë. Nga ana tjetër, të gjitha partitë "e vogla" nxituan t'i vendosnin vetes kurorën e vendit të tretë. Kështu, prej disa muajsh, gara elektorale njeh, si askund tjetër, dy fitues të vendit të parë dhe një dymbëdhjetë të vendit të tretë. Dhe, deri tani, askush nga partitë politike nuk ka pranuar të ulët në "podiumin" bosh, të vendit të dytë.

Thua të gjithë të jenë aq naivë dhe të mos dinë ta lexojnë mirë vendin në të cilin i vendosi vota e popullit? Vështirë të besohet. Pjesëmarrja shumë e ulët në votime nga të gjithë politikëbërësit shqiptarë duhej lexuar si dështim. Partia më e madhe e pozitës tek 34%* do të dinte të lexonte konsumimin që ka ardhur nga shtatë vjet në qeverisje, lodhjen nga konfliktet e brendshme, zhgënjimin nga moszgjidhja e problemeve ekonomiko-sociale të shtetasve; partia më e madhe e opozitës tek 33%* do të dinte të lexonte mosbesimin që vazhdon të



ketë elektorati tek politika dhe qëndrimet e saj; partitë e tjera, tek përqindjet modeste (kush më shumë e kush më pak) do të dinin të lexonin dështimin e alternativave me emra, por jo me programe.

Por, askush nuk di dhe nuk do t'i lexojë shifrat ashtu siç janë. Kjo është loja që kryetarët e partive bëjnë prej vitesh. Dëshira për të qenë kryetarë të përjetshëm bën që ata të mos i pranojnë humbjet, madje t'i paraqesin si fitore. Askush nuk pranon që ka humbur, që ka dështuar, askush nuk pranon të japë dorëheqjen. Tek ne institucioni i dorëheqjes nuk njihet dhe nuk pranohet nga askush. Kryetarët vazhdojnë t'i konsiderojnë partitë çifligje me të cilat mund të bëjnë ç'të duan. Duke folur për politikën shqiptare dhe partitë politike, një i huaj u shpreh: "Ju nuk keni parti, keni vetëm dy kryetarë(!)!"

Dhe kryetarët e partive shqiptare janë të përjetshëm, ata e "kanë me tapi" atë post, dhe nuk e lënë të paktën deri në gjallje të tyre. Ndoshta ky zakon është i trashëguar nga "nëna" parti, nga e cila vijnë të gjitha "bijëzat" e sotme.


Për këtë shkak të gjitha partitë politike deklarojnë se këto zgjedhje kanë konfirmuar edhe një herë sukseset e tyre. Mungesa e një analize të thellë do të thotë mungesë reflektimi, do të thotë mungesë përmirësimi dhe progresi. Dhe ndodh, ashtu siç po ndodh, që partitë në Shqipëri, prej vitesh, jo vetëm pamjen (kryetarët), por edhe programet i kanë të njëjta. Dhe ndodh ashtu siç, për fat të keq, po ndodh, që Shqipëria në vend të progresit dhe ecjes përpara, po vazhdon "në vend numëro".

Nuk ka si të ndodh ndryshe. Janë pikërisht këto parti, këta lider që bëjnë politikën e Shqipërisë, që hartojnë ligje, miratojnë qeveri, hartojnë politika zhvillimi... Kur mielli është i prishur nuk mund të presësh që buka të vijë mirë.

Iku dhe një vit, motmoti i ri trokiti me një tragjedi të cilës iu vu kapaku me një shfaqje kllounash në Parlament.

Partitë politike do të vazhdojnë të krenohen me sukseset e tyre, ndërsa shqiptarët do të vazhdojnë të numërojnë dështimet e politikës dhe politikëbërësve të tyre...

*Lexuesit të më falin nëse ndërkohë këto shifra mund të të kenë ndryshuar.



Nga Artan ÇELA,
Anëtar i PS / Gazetar

QEVERISJE ME PJESËMARRJENE PUBLIKUT

TASHMË KUR kanë kaluar mbi 13 vjet nga përmbyssa e sistemit totalitar komunist, qytetari shqiptar vazhdon të përballet me një sërë problemesh jo vetëm të mirëqenies materiale, por edhe të qeverisjes. Në të vërtetë në një sistem demokratik të dyja këto çështje, të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën, përbëjnë një nga hallkat bazë të zhvillimit dhe konsolidimit të këtij sistemi. Në kushtet aktuale të vendit tonë mosfunksionimi siç duhet i këtyre dy çështjeve duket se po e vë në rrezik edhe vetë ekzistencën e sistemit. Dhe kjo për disa arsye, po të kihet parasysh mirëfunksionimi i demokracive në vende të tilla si Shtetet e Bashkuara, Anglia dhe shtetet e Evropës Perëndimore.

Në konceptin modern të funksionimit të demokracisë vetë demokracia është pjesëmarrje e qytetarëve në qeverisjen e vendit nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të saj nga vota e lirë dhe e drejtëpërdrejtë.

Në fakt, në Shqipërinë e pasviteve '90 ky koncept nuk ka mbetur tjetër veçse një formulim teorik për të gjitha forcat politike që e kanë marrë pushtetin në periudha të ndryshme. Dhe kjo për faktin se këto forca politike, herë të vetme dhe herë të bashkuara në koalicione, e kanë harruar dhe e kanë shmangur këtë përgjegjësi që u jep pushteti i ardhur nga


SISTEMI ZGJEDHOR NE SHQIPERI, Ç'ESHTË DHE Ç'DUHET TE JETE

KA NJË

POSTULAT

NË NË SHKENCËN QË

STUDION SISTEMET ZGJEDHORE:

Nga Arben QIRJAKO,
Nënkryetar i FRPD

çdo popull ka atë sistem zgjedhor që meriton, sepse çdo popull ka në mënyrë të paevitueshme ata politikanë që meriton dhe sistemin zgjedhor të një vendi e përcaktojnë politikanët sipas modelit të tyre.

Sistemi zgjedhor në Shqipëri thuhet se është sistem me tendencë të theksuara mazhoritare. Arsyeja themelore është sepse të gjithë mendojnë se politikën në këtë vend e bëjnë politikanë “të fortë”, autoritaristë. Sistemi mazhoritar është sistem që funksionon dhe ka sukses për parti që kanë me shumicë personalitete të forta dhe me autoritet, për të tjerët ai është gjyle në këmbë. Për këtë arsye, të tjerët e kanë gjetur arsyen e mosarsyes së tyre në trajtimin e sistemit tonë elektoral si sistem mazhoritar, ose në thelb mazhoritar.

Në fakt, me përjashtim të zgjedhjeve të vitit 1996, kur sistemi ynë elektoral ka pasur tipare mazhoritare, të ngjashme me ato që shfaq sot sistemi italian i zgjedhjeve, në të gjitha rastet e tjera sistemi elektoral ka pasur tipare shumë të theksuara proporcionale.

Formalisht sistemi ynë elektoral hyn në kategorinë e sistemeve të përziera elektorale, ku zgjedhjes së drejtpërdrejtë të kandidatëve nga zona njëemërore, i bashkangjitet zgjedhja e një numri prej tyre nga lista shumëemërore të partive politike, sipas një formule kushtetuese e cila siguron kompensim të lartë proporcional të përbërjes së parlamentit. Parlamenti ka 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen nga po aq zona njëemërore, kurse 40 nga listat shumëemërore të partive në bazë të rezultatit nacional të arritur prej tyre. Matematikisht formula e kompensimit është e aftë që në kushte normale aplikimi të sigurojë kompensim të plotë proporcional. Secila parti parlamentare merr në Kuvend aq vende sa i takojnë sipas

përqindjes së votave që ka marrë në shkallë vendi. Praktikisht, për shkak të aplikimit sui generis (*sui generis- enfemizëm për shkëlqen e ligjit*) nga ana e pushtetit, siç ndodh rëndom në Shqipëri, në zgjedhjet e vitit 2001 proporcionaliteti kushtetues pati tendencë të theksuara mazhoritare. Kjo për shkak të disa historive me “Dushk” që na serviri Qeveria dhe që i dhanë të majtës shqiptare aq deputetë, sa nuk do të mund ti merrte dot me hak..

E gjithë kjo histori e komplikuar ka çuar në mënyrë të paevitueshme në kërkesën e rradhës për ndryshimin e sistemit elektoral. Këtë herë ka një konvergim të shumicës dërrmuese të forcave politike shqiptare në drejtim të sistemit proporcional të zgjedhjeve. Avantazhi thelbësor i sistemit proporcional është se forcën e personaliteteve të forta e zëvendëson me forcën e partive politike. Kjo ecën mirë për sa kohë që partitë nuk bëhen aq të forta sa të na zënë frymën. Format që përfliten më së shumti janë dy: sistem proporcional rajonal dhe sistem proporcional kombëtar. I pari ka të gjitha avantazhet e sistemit proporcional dhe rrit pragun e futjes në parlament (*gjë që i pëlqen partive të mëdha*); i dyti ka të gjitha avantazhet e sistemit proporcional dhe mund të ruajë pragun e ulët që kemi sot (*gjë që u vjen për shtat partive të vogla*). Në zgjedhjet e ardhshme ka shumë të ngjarë që sistemi të ndryshojë.

Me siguri që sistemi elektoral që do të miratohet do të jetë ai që meritojmë.

vota popullore. Të zgjedhurit e këtyre partive, vetëm pak kohë pasi e fituan mandatin, filluan të shkëputeshin nga elektorati që i votoi dhe të cilin i patën premtuar “qiejt” gjatë fushatave të tyre elektorale. Në këtë mënyrë, midis të zgjedhurve dhe qytetarëve filloi të krijohet një hendek i thellë, i cili në të shumtën e rasteve shoqërohet edhe me humbjen e ndershmërisë dhe ndërsjellshmërisë midis të zgjedhurit dhe qytetarëve, madje që vazhdon ende. Pikërisht ky fenomen i rrezikshëm e cënon rëndë virtytin qytetar të besimit. Sot të gjithë ne, në pozicionin e qytetarit, njëherësh edhe të votuesit, jemi dëshmitarë të një fakti të tillë.

Nëse në fillimet e proceseve demokratike dy prej partive më të mëdha të politikës shqiptare, Partia Socialiste dhe ajo Demokratike, u kthyen në idhuj të militantëve të tyre, tanimë ato kanë humbur jo vetëm një pjesë të madhe të këtyre militantëve dhe ish-anëtarëve të tyre të zjarrtë, por kanë humbur edhe elektoratin qytetar. Dhe kjo për faktin se përfaqësuesit e tyre në qeverisje, qoftë në atë lokal apo qendror, pasi hipën në karrigen e pushtetit, i braktisën. Në këtë mënyrë, fryma e dashamirësisë dhe e bashkëveprimit të ideve midis qytetarëve dhe të zgjedhurve të tyre për

përmirësimin e jetesës dhe për zgjidhjen e problemeve të komunitetit ka degjeneruar. Pikërisht mungesa e besimit reciprok i ka bërë tashmë të dyja palët që t'i shmangen bashkëpunimit, duke cënuar kështu hapur një nga parimet-bazë mbi të cilat funksionojnë demokracitë moderne: “Qeverisje me pjesëmarrjen e publikut.” Por, “faji” dhe përgjegjësia këtu nuk është vetëm e njëres palë. Nga një krah qëndrojnë strukturat qeverisëse, të cilat, duke cënuar hapur të qenit transparent apo, e thënë më shqip, të qenit të hapur, e shkëput qytetarin nga e drejta e vet vendimmarrëse, duke e vënë kështu në rrezik jetën publike. Në krahun tjetër, edhe vetë qytetarët me indiferentizmin e tyre bëhen “përkrahës” të një qeverisjeje të keqe.

Pikërisht për këtë pikë ata duhet të kenë veçanërisht parasysh një thënie të Ciceronit: “Vetë ata nuk janë një grumbull qeniesh njerëzore të mbledhura bashkë në një mënyrë çfarëdo, por janë një grumbull njerëzish me përmasa të mëdha, të bashkëlidhur me një marrëveshje e cila ka të bëjë me drejtësinë dhe partneritetin për të mirën e përbashkët.”

ESHTË KOHA PËR TE DEGJUAR

JO RRALLË NË bisedat

politike, por edhe në shtyp janë hedhur ide për rolin e gruas në vendimarrje, janë bërë diskutime për domosdoshmërinë e përfshirjes së saj në jetën politike, si dhe mjaft fenomene të shumta që e shoqërojnë këtë dukuri të shoqërisë shqiptare. Aq më tepër kur tashmë shihet se nga një heshtje totale e medias për problemin e gruas në karrierë, ka një rritje të kurbës së interesimit për këtë çështje. *"Problemin e gruas unë do ta quaja aq të mprehtë sa edhe gjakmarrja"* - thotë Marieta Pronjari,

"Sepse nëse këto ritme të mjerueshme të pjesëmarrjes së gruas në politikë nuk vlerësohen me seriozitetin e duhur, për pak vjet gruaja do të izolohet pothuajse krejtësisht".

Një shqetësim jo pa vend. Politika është ajo që i ka borxh shumë gruas. Është një ndër fushat ku pozicioni i gruas në mini-minorancë është i lexueshëm. Edhe në vendet e përparuar punohet shumë për barazim gjinor. Pavarësisht nga rezultatet apo treguesit, ndjeshmëria për këtë problem është e lartë. Po t'i referohemi vetëm Kosovës, me një mentalitet disi të ndryshëm nga ne për emancipimin e gruas, përsëri përfaqësimi i saj në vendimarrje është me tregues real: në tre deputetë një është grua.

Të zbrisim në një plan më konkret tek ne. Pak kohë ka nga përfundimi i zgjedhjeve lokale. U punua shumë nga organizma të ndryshme të brendëshme e ndërkombëtare për përfaqësimin e gruas në politikë, për dhënien e akseseve të nevojshme për të treguar se gruaja nuk mund dhe nuk ka pse të përjashtohet nga asnjë prej proceseve të vendimarrjes, qofshin qendrore apo lokale. Shumë takime, seminare, rregullore të shkruara dhe të pashkruara, biseda në qendër e në bazë, por, për fat të keq impakti i tyre ka qenë thuajse i papërfillshëm. Mjafton t'u referohesh rezultateve të zgjedhjeve të fundit, ku gruaja përfaqësohet në një masë që mund të numërohet me gishtat e dorës.

Demokracia është pjesëmarrje dhe mundësi të drejta e të barabarta. Akoma nuk kuptohet që gratë kërkojnë vetëm atë që u takon në qeverisje dhe vendimarrje. 51% e shoqërisë përfaqësohet në politikë në nivelet më të ulta. Kjo është pasojë e agresivitetit të burrave ndaj grave, mungesës së kulturës, veçanërisht nga ana e politikëbërësve shqiptarë. Të krijohet bindja se kemi të bëjmë me një politikë primitive përsa i përket problemit të gruas. Gjithkush prej nesh i ndoqi hapjet e fushatës elektorale. Mes atyre spektakleve shumëëndritës për prezantimin e kandidatëve për kryetarë bashkish, gjithçka ishte menduar mirë, sipas specifikës së secilës parti, por askush nuk kishte menduar se opinioni do t'i gjykonte ashpër ata që bënë listat e politikanëve vendorë. Nuk u gjend asnjë zonjë e nderuar, me *background* e me një formim dinjitoz që të drejtonte ndonjë nga bashkitë e vendit? Dhe

Nga Antoneta MALJA,
Anëtare e Këshillit Kombëtar të PD

aq më tepër ngarkohet problemi kur shprehen se "gratë duhet të punojnë më shumë, se është në dorën e tyre!" Për çfarë duhet të punojnë më shumë, për t'u mbushur mendjen burrave që kanë lapsin të vendosin edhe për to? Rrugët për t'u përfaqësuar në politikë janë të shumta dhe të gjitha kalojnë nëpërmjet partive politike. Janë këto organizma që më tepër se kushdo i janë borxhlie gruas: që nga përzgjedhja e deri në hartimin e listave, që bëhen sa për të qenë në rregull formalisht. Shikoni listat për këshilltarë. Vendet e para i kanë zënë si gjithnjë burrat... Teoria e përjashtimit funksionon në mënyrë të sofistikuar.

Pesonalisht vlerësoj ato zonja që me përkushtim e dinjitet kanë dhënë shumë për politikën, por që mendoj se në të ardhmen duhet të bëjnë më shumë për gruan, të kërkojnë një vullnet më të plotë politik për të mbështetur gruan në vendimarrje. Kontributet e gruas janë të shumta. Politika e sotme ka nevojë për një drejtim më paqësor. Është kjo një ndër arsytet pse kjo shoqëri duhet të sensibilizohet se pa gruan nuk mund të zhvillohet demokracia për të cilën kemi aq shumë nevojë.



BASHKIMI I OPOZITES, NEVOJË DHE DOMOSDOSHMËRI

Nga Desdemona GABA,
Anëtare e Këshillit Kombëtar të PBK



DUKE IU REFERUAR rezultatit të zgjedhjeve të fundit lokale, megjithë parregullsitë e konstatuara, fakti që të bie në sy është diferenca fare e vogël midis mbështetësve të partive të djathta dhe atyre të majta. Ç'do të kishte ndodhur nëse të gjitha partitë e djathta do të ishin bashkuar në një front të vetëm me kandidatë të përbashkët?

Të gjithë e marrim me mend rezultatit: një fitore e sigurt e forcave të djathta. Përçarja e krahut të djathtë të spektrit politik nuk është një veçori tipike për Shqipërinë.

Dihet që në shumë prej shteteve ish-komuniste të Evropës Lindore partitë e djathta janë të shumta megjithë ndryshimet fare të vogla në programet e tyre. Kjo është një rrjedhojë e natyrshme e diktaturave të gjata komuniste ku të majtën e karakterizon një unitet i trashëguar. Në disa prej këtyre vendeve, si Poloni, Bullgari etj. janë krijuar koalicionet solide të forcave të djathta, gjë që ka çuar në fitoren e pashmangshme të tyre.

Një shembull tipik është ai i Polonisë ku në vitin 1995 u zhvilluan zgjedhjet presidenciale dhe e djathta polake u paraqit me disa kandidatë. Në këto zgjedhje nuk fitoi asnjë nga kandidatët e djathtë, në fuqi erdhi Alexander Pashnevski, i majtë, me një shumicë parlamentare të majtë. Vetëm 2 vjet më pas, në 1997, e djathta polake e kuptoi rëndësinë e një të djathte unike përballë një të majte të konvertuar nga komuniste në social - demokratë. Bashkimi i jo me pak, por 42 grupimeve politike të djathta çoi



Nga **Anuela KONDI**,
PS, Tiranë

NË VORBULLËN E REALITETIT TË POLITIKËS

Eksperiencat e partive politike evropiane, të majta dhe të djathta, sigurisht që ofrojnë shumë zgjidhje, por ato ose nuk janë përkthyer akoma ose nuk janë votuar prej forumeve të larta.

SHQIPËRIA QË PREJ 12 VJETËSH po përjeton një realitet politik krejtësisht të ndryshëm nga ai i 50 viteve me radhë. E plagosur, e topitur, e përgjumur, u zgjua prej zërave të fuqishëm studentorë që kërkuar pluralizëm. Pas lindjes së partisë së parë opozitare, vendi nuk gjeti qetësi nga partitë që vazhdojnë të krijohen përditë, të vogla e të mëdha, me emra nga më të çuditshmit.

E vërteta është që secila prej tyre ka një Statut dhe Program tërësisht Perëndimor, të përzgjedhur me kujdes nga përkthime të dokumentave bazë të partive simotra evropiane. Por... për fat të keq, edhe pse politika shqiptare duhet të kishte drejtim perëndimor, realiteti politik qëndron shumë larg nga ai që pretendohet. Mentaliteti është po ai i para viteve nëntëdhjetë, veçse i veshur me një kostum tjetër, modern.

Ekzistojnë tek ne parti të djathta e të majta, të grupuara në koalicione apo që veprojnë të vetme; ekzistojnë të tilla që u ndihet zëri vetëm kur kryetari kërkon të bëhet i njohur (t'i mësohet emri) në media para ndonjë

...vijon në f. 10

në fitoren e zgjedhjeve parlamentare të vitit 1997. Ky koalicion u ngrit në bazë të disa parimeve të cilat u sanksionuan në një Kartë dhe që u respektuan nga grupimet pjesmarrëse.

Shembuj të tillë të koalicioneve që kanë çuar në fitore janë të shumtë në demokracitë evropiane dhe më gjerë. Është pikërisht një aleancë e tillë për të cilën ka nevojë opozita shqiptare sot.

Është detyrë imediate e Partisë Demokratike dhe e partive të tjera të djathta që të krijojnë një koalicion të fuqishëm, përballë një të majte që ka mëse 6 vjet që po demonstroi hapur paaftësinë e saj për të ndërtuar shtet. Një shtet të vërtetë të ngritur mbi parimet themelore të demokracisë, që t'i ofrojë çdo shqiptari mundësi të barabarta. Forcat e djathta në Shqipëri i kanë të gjitha potencialet politike dhe intelektuale për të bërë ndryshimin e madh.

Por, përpara sesa t'i kërkohej vota elektoratit shqiptar, të lodhur nga një tranzicion pa fund, le t'i japim atij mesazhin e bashkimit në një front të vetëm progresist. Në një koalicion ku, mbi çdo interes të vogël, të vendoset qëllimi final: kthimi i besimit të njerëzve tek shteti dhe politika. Ky besim i humbur, që pasqyrohet edhe në pjesmarrjen e ulët të popullsisë në zgjedhje, nuk mund të fitohet pa inisiativa dhe veprime të qarta politike.

Një bashkëpunim konkret i opozitës, duke lënë mënjanë çështjet që i ndajnë (që janë shumë pak të rëndësishme përballë realitetit shqiptar) dhe duke u fokusuar në çështjet e përbashkëta, do të rriste besueshmërinë edhe të shqiptarit më indiferent. Një koalicion është vërtet i tillë vetëm kur të gjithë pjesmarrësit kanë një rol konkret për të luajtur dhe japin maksimumin e tyre për të arritur atë që nuk mund ta arrijnë të vetëm.

Kur, më shumë se në këtë kohë, i duhet dhënë këtij vendi mesazhi i një opozite të përkushtuar për t'i siguruar çdo qytetari shqiptar nevojat jetike?

Është pikërisht koha për të nxjerrë mësim nga ndonjë bashkëpunim jo i suksesshëm i së shkuarës, ku ndoshta ka munguar përvoja e duhur politike dhe për të aplikuar përvojat e suksesshme të vendeve të tjera të zhvilluara.

Ky vend ka nevojë për një mentalitet të ri politik që të ecë përkrah zhvillimeve politike perëndimore. Ky mentalitet nuk është më një nocion thjesht teorik. Tashmë ekzistojnë burimet e duhura njerëzore që kanë eksperiencë dhe kualifikim politik për të ndërtuar struktura politike të përgjegjshme.

Ka nevojë për një lidhshmëri të kompletuar, me të gjitha tiparet dhe virytet e një udhëheqjeje moderne, që të mësojë nga e shkuara dhe të projektojë të ardhmen.



Gago APOSTOLI,
NËNKRYETAR I PSD

Bashkëpunimi me NDI është pjesë e rëndësishme e formimit tim politik. Këtë uroj edhe për liderat e rinj që ky institucion po përgatit në Shqipëri.



Nikollë LESI,
KRYETAR I PDK

Ambicjet e PDK për një të ardhme të sigurtë dhe të përbashkët me vendet e BE janë të garantuara nga eksperiencat dhe trainimet që NDI me shumë sukses ka bërë për kuadrat tona dhe nëpërmjet tyre për degët e PDK nëpër rrethet



Ilir ZELA,
KRYETAR I KOMISIONIT
PARLAMENTAR PËR POLITIKËN E
JASHTME

NDI ka zgjedhur të japë ndihmën e saj në formimin e njerëzve që do të kontribuojnë për ta bërë të vetëmbajtshme demokracinë në Shqipëri.

...vijon nga f. 9

fushate, por që akoma nuk e ka qartësuar në mendjen e vet “nga i pret timoni”.

Ekzistojnë amalgama koalicionesh të çuditshme, ku monarku dhe republikani luftojnë për të njëjtën kauzë, ku socialisti dhe demokraci ulërasin për shtresën e varfër, ku agrari kërkon lehtësira për biznesin e madh, ku komunisti biznesmen mallkon borgjezinë “që po i pi gjakun popullit”. Dhe, nga ky pështjellim ideologjik, të vjen mendja rrotull e nuk u beson dot syve kur sheh politikanët të kacafyten në “mbrojtje të vijës ideologjike” të partive respektive.

Në fjalorin e përditshëm politik dëgjon rëndom fjalët *demokraci e brendshme, e drejtë statutore, kongres, dorëbeqje...* Flitet e flitet prej gjithkujt... por, janë veç fjalë. Që prej 12 vjetësh, që nga krijimi i tyre, pothuaj të gjitha partitë vazhdojnë të drejtohen nga i njëjti kryetar. Të gjitha partitë kanë qëlluar në shenjë me të parën, “fatmirësisht” kanë zgjedhur kryetarin e duhur, të “pagabueshmin”, të “pazëvendësueshmin”, atë që i ka çuar “nga fitorja në fitore”, (ose nga një humbje në tjetrën, por kjo nuk ka rëndësi) .

Që prej 12 vjetësh shohim në tryeza të rrumbullakta apo në tribuna protestash të njëjtët persona, që thonë të njëjtat fjalë, që bëjnë të njëjtat gjëra... dhe Shqipëria qëndron në të njëjtën gjendje: e lodhur, e varfër, e vrarë, e pafuqishme as të qajë dhe as të qeshë. Çdo parti është e organizuar në degë e nëndegë, në organizata e këshilla zonale, ku anëtarët diskutojnë e marrin vendime, zgjedhin e zgjidhen... e, në fund, në kongres, i njëjti rezultat!!! Se ka kongres, po ka edhe kryetar, se ka delegatë, po ka edhe përzgjedhje, se ka mendim ndryshe po ka edhe vendim politik. Dhe... i njëjti rezultat... Shqipëria vazhdon të lëngojë e zhytur në errësirën e energjisë që e paguan shtrenjtë, në varfërinë e çmimeve të larta, e kuruar prej mjekimeve alla “doktor Adhamudhi” . . .

Dhe deri atëherë kur çdo anëtar partie do të ketë të drejtë të votojë për çdo vendim që ka të bëjë me të ardhmen e partisë së vet, Shqipëria do të çapitet me hapin e breshkës, ndonjëherë edhe të gaforres, duke u ngopur me lugën bosh e duke përsëritur refrenin “Bir Selman i nënës, kë të qaj më parë...”



PRONA PRIVATE, “ELEMENT SIGURIE” PËR PASAPORTËN EUROPIANE TË SHQIPËRISË

Nga Edvin ZOTO

*Sekretar i Përgjithshëm
i FRPR*

SFIDA AKTUALE e Qeverisë Shqiptare është integrimi në Evropë, dëshira e pamohueshme e çdo shtetasi shqiptar sot është integrimi në Evropë.

Po a mund të integrohet Shqipëria kur edhe mbas 14 vitesh demokraci ende nuk është zbatuar një nga elementët më të domosdoshëm të saj, kur ende shqiptarët nuk po gëzojnë pronat e trashëguara nga baballarët e tyre?

Dhe natyrishtëm përgjigja vjen jo.

Prona private, kjo e drejtë e pamohueshme e çdo shqiptari mban në themel të saj në këta 14 vjet shumë urrejtje, shumë probleme sociale dhe, për ironi, shumë pak investime, shumë pak progres, aq të dëshiruar për çdo komb.

Po të kthehemi në retrospektivë dhe të analizojmë sadopak, do të kuptojmë se ishte ligji 7501 - ligji famëkeq pas atij të Reformës Agrare të zbatuar nga diktatori Hoxha, i cili i rimori pronën pronarit të ligjshëm dhe ia dha një tjetri që habitshëm e pa veten pronar i një prone që nuk ishte e tija. Këtu ishte edhe pikënisja e problemeve sociale për popullin tonë. “Pronarët e rinj” nuk e punonin tokën dhe nuk investonin

në të, pasi ishin koshientë që një ditë drejtësia do të shkonte në vend. Një tokë mjaft frytdhënëse, por që ngelej e shkretë, e braktisur për shkak të gabimit të disa politikanëve. E, ndërkohë, ironia e fatit vazhdonte, kur nga shtetet fqinje vinin prodhimet e ndryshme bujqësore e fshatari ynë ishte i detyruar t'i blinte. Edhe ata pak pronarë të paligjshëm që morën kurajon për të investuar në pronën e tjetrit, sot ndodhen gjykatave në seanca të pafundme gjyqesh me pronarët e ligjshëm. E deri sa të zgjidhen konfliktet, investimet e tyre modeste qëndrojnë të mbyllura, njerëzit të papunë, arkat e shtetit bosh, për shkak të mosmbledhjes së tatimeve, e vargu i problemeve sociale zgjatet pambarimisht. Dhe ne kthejmë sytë nga të huajt dhe pyesim: Ku janë investitorët e huaj, firmat prestigjioze që i shikojmë nëpër televizione? Pse nuk vijnë të investojnë në Shqipëri? Ata nuk vijnë, nuk afrohen të investojnë pasi në momentin më të parë ndodhen përpara dilemës se kush është pronari i vërtetë i truallit? Pse duhet të pagujë dy pronarë tek dihet botërisht që pronari i ligjshëm është vetëm një? Pse duhet të presë sa të zgjidhet problemi i pronës në Shqipëri, kur mund të investojë në një vend tjetër? Gjithë ky kaos. Gjithshka në dëm të Shqipërisë, gjithshka në dëm të shqiptarve. Po pse tërë kjo amulli? Kujt i shërben ky kaos me pronën private?

Ndoshta nga padituria qeveritë shqiptare nuk kanë arritur të kuptojnë ende se, pa zgjidhur këtë element të demokracisë, pa kthyer pronën tek pronari i ligjshëm, nuk do të ketë kurrë investime serioze në Shqipëri nga investitor të huaj dhe vendas, nuk do të ketë kurrë progres e mirëqënie për shqiptarët, nuk do të shuhen kurrë vrasjet e vëllavrasjet për një rrip tokë e për një metër gardh, nuk do të fashiten kurrë problemet sociale që lindën prej saj.

Është një apel për Ju, zotërinj politikanë, të vini në vend këtë të drejtë që u është mohuar pronarëve shqiptarë për vite me radhë, nga politikant tujja jo integruese. Është koha kur Ju keni në dorë të mbyllni njëherë e përgjithmonë këtë plagë sociale të shoqërisë shqiptare. Është koha kur Ju keni në dorë fatin e këtij kombi që ta integroni atë në Evropë, ashtu si i ka hije shqiptarit.



SHQIPTARËT DHE FQINJËT

Nga Florjan XHUTI

Kryetar i FR të PBK

“Në gushtin e 1900 zura për herë të parë një fill të lëmshit ballkanik, pa kujtuar se sa thellë do të ngatërrohesha më vonë dhe, aq më pak, se si ky lëmsh do të mplekste, më në fund, të

gjithë botën”- kështu shkruan Miss Edith Durham në “20 vjet ngatërresa ballkanike”.

Çështje e drejta, Ballkani i koklavitur nuk fillon më 1900, kur e nderuara zonja Durham pati rastin ta vizitojë. Historia e Ballkanit të ngatërruar fillon shumë herët, fillon që atëherë kur sllavët u dyndën për t'u larë në ujërat e ngrohta të Mesdheut. Por, nëse llogaritë ishin të mbyllura ku mirë e ku keq për shkak të qënies së Perandorisë Turke, fillimi i shekullit të kaluar do të sillte hapjen e plagëve të vjetra dhe përgjakjen e Gadishullit, dukuri e cila hapur apo me maskë, shoqëroi këtë rajon për gjithë Shekullin e XX.

Tronditjet e forta, deri në klithje, që ka patur Rajoni janë për shkak të qënies akoma gjallë të një paradoksi që, Presidenti Uillson do ta denonconte që në vigjilje të shekullit dhe, diku në fund të tij, pasardhësi Klinton do t'i shpallte luftë këtij paradoksi si rrënues të vlerave të demokracisë.

Në Ballkan ka një pakuptim ku “kombi” dhe “shteti” nuk përputhen në përmasa marramendëse me njëri-tjetrin. “Shmangia” është e pranueshme, por jo në atë nivel sa të përmbysë të vërtetën. Në Rajon deformimi është goxha i madh, aq sa shformon realen. Shembulli më tipik i rajonit janë Shqipëria dhe shqiptarët. Gjatë ngjarjeve jo të qeta të shekullit të kaluar e në vazhdim, fjalën “shqiptar” do ta hasje shumë herë më shumë se fjalën “Shqipëri”. Kjo ndodh për shkak të atij pakuptimi ku Shqipëria nuk përputhet me shqiptarët. Të njëjtat ngjarje, në mos më keq, do të ndodhnin sikur të kishin detyruar ndonjë vend tjetër që të përfaqësohej vetëm nga kryeqyteti apo një krahinë e tij.

Në Gadishullin Ballkanik gjendet një popull, i cili nuk ka jetuar kurrë vetë dhe as për vetveten. Fati jo i mirë gjatë gjithë shekujve, ka qenë t'i japë pareshtur kombeve fqinjë vlerat e tij njerëzore. Shqiptarët kanë qenë rezervuarit ku grekët, rumunët, bizantët dhe turqit janë ushqyer me radhë. Aftësitë intelektuale të shqiptarëve dhe vlerat e tyre janë shfaqur në një mënyrë apo një tjetër. Midis tyre ka patur njerëz të mëdhenj që janë ngritur disa herë mbi mesataren. Për të vlerësuar më mirë veprimtarinë e shqiptarëve duhet t'i shohësh jashtë vendit të tyre, atje ku dhe janë çmuar më shumë.

Është e vërtetë se në këtë rajon nuk janë vetëm shqiptarët. Në Jug të tyre janë edhe ata që shpikën teatrin. Pikërisht atje, shumë shpejt më parë mori jetë fjala “demokraci”, por mos të harrojmë edhe “anarki”. Bukuritë magjepëse kulturore, arti, qytetërimi antik grek kanë vdekur shumë vite para Krishtit, madje, kur sheh rradhët e gjata në kufi, apo racizmin ndaj emigrantëve, të duket se Perikliu nuk ka jetuar asnjëherë. Besoj se grekëve nuk do t'u “prisheshin” kompjuterat në kufi po të dinin të respektonin atë që i themeloi shtetin e tyre, shqiptarin Capò D'Istria, apo suliotët që iu dhanë pavarësinë dhe që, deri ditën që filluan të shesin e blejnë me Euro, i kishin të stampuar në kartmonedha.

Asnjëherë nuk ka qenë në Ballkan. Gjithmonë e përfshirë në të. Më shumë ka marrë dhe dhënë me shqiptarët se me të tjerët. Për të nderuar të kaluarën, italianët duhet të bëjnë diçka për këtë komb. Ata, falë Skënderbeut, sot nuk bëhen synet apo nuk u detyruan të venë çallmë. Italia, kaq e afërt, nuk po arrihet edhe duke u paguar me jetë nga shqiptarët. Përmenda dy nga fqinjët, pasi tek të dy historia është më serioze. Me të tjerët ndryshimi është fare i prekshëm. Komentet do të ishin të tepërta. Në lindje të mijëvjeçarit të ri raca shqiptare i dha botës Shën Terezën, kurse të tjerët dihet ç'bënë – gjetën punë për gjykatësit e Hagës. Në të vërtetë shqiptarët kanë dhënë pak për vendin e tyre. Nga veprimtaria, gjaku dhe talentet e tyre kanë përfituar jo pak të tjerët. Ata kanë dhënë ç'kanë patur më të mirë për të mirën e të tjerëve. Kështu ka qenë deri tani. Besoj se po vjen një kohë e re që ata të punojnë për vete.

“Po çfarë kërkimesh duhet të bëj në Kostandinopojë, Kajro, Hydra që të hedh dritë mbi këtë racë guximtare shqiptare? Ky popull vepron shumë, por nuk shkruan asgjë”. Këto fjalë të mbushura me melankoli janë shkruar nga princesha e Moldavisë, shqiptarja Dora D'Istria.

Ballkani sot i ngjan një fëmijë bastard, i pjellë nga historia dhe marrëveshjet e fshehta. Normaliteti do t'i kthehet kur Rajoni të administrohet nga shtetet – kombe, atëherë kur identiteti i njërit nuk do të përpiqet të verë nën vete identitetin e tjetrit.

Në këtë kohë do të fillojë edhe integrimi.



Kreshnik ÇOLLAKU,
SEKRETAR I PERGJITHSHEM I PDR

Ky program është një shkollë e vërtetë për të rinjtë që aspirojnë të sjellin ndryshim.



Musa ULQINI,
KRYETAR I DEGËS SË PS TIRANË

Programin e NDI mbi Menaxhimin Politik, mund ta cilësoj si pjesë të suksesit të angazhimit të NDI në Shqipëri dhe në të njëjtën kohë si një ndihmë shumë e rëndësishme që i jepet emancipimit të politikës shqiptare



Egerem SPAHIA,
KRYETAR I PLL

NDI ka luajtur një rol të rëndësishëm në kualifikimin e politikanëve të rinj, në kushtet e mungesës së një shkolle të mirëfilltë të Politikës në Shqipëri.